



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.38

2004

16 Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9230 datë 13.5.2004	Për ratifikimin e "Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit"	2793
Ligj nr.9232 datë 13.5.2004	Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane	2800
Ligj nr.9233 datë 13.5.2004	Për një shtesë në ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit"	2813
Ligj nr.9234 datë 20.5.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e fazës së dytë të projektit të Spitalit të Përgjithshëm Durrës"	2814
Dekret nr.4243 datë 8.6.2004	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Hudenisht, qarku Korçë	2822
Dekret nr.4244 datë 8.6.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2823

Vendim i KM nr.349, datë 1.6.2004	Për fillimin e negocimit për dhënien me koncesion të zonës së Porto-Romanos, Durrës dhe për disa ndryshime në vendimin nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive, që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare, për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre” 2823
Vendim i KM nr.350, datë 1.6.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të reparitit ushtarak nr.1023 në qytetin e Vlorës, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”..... 2824
Vendim i KM nr.351, datë 1.6.2004	Për një shtesë në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” 2825
Vendim i KM nr.352, datë 1.6.2004	Për heqjen nga lista e sektorëve strategjikë dhe kalimin në privatizim a mbyllje të fabrikës së pasurimit të kromit, në Kalimash, në qarkun e Kukësit 2828
Vendim i KM nr.353, datë 1.6.2004	Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për sigurimin e jetës së ushtarakëve në misionet jashtë shtetit, edhe në raste aksidentesh në grup 2829

LIGJ
Nr.9230, datë 13.5.2004

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË KONVENTËS EUROPIANE
PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli ndryshues i Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4238, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**PROTOKOLL PËR NDRYSHIMIN E KONVENTËS EUROPIANE PËR SHTYPJEN E
TERRORIZMIT**

(Miratuar nga Komiteti e Ministrave më 13 shkurt 2003 në takimin e 828 të Zëvendës ministrave)

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokollit,

duke marrë parasysh Deklaratën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të 12 shtatorit 2001 dhe vendimin e tij të 21 shtatorit 2001 mbi luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe Deklaratën e Vilniusit mbi bashkëpunimin zonal dhe konsolidimin e stabilitetit demokratik në Europën e zgjeruar nga Komiteti i Ministrave në sesionin e 110-të në Vilnius me 3 maj 2002;

duke marrë parasysh rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1550 (2002) mbi luftën kundër terrorizmit dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

duke marrë parasysh Asamblenë e Përgjithshme të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara A/RES/51/210 mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe deklaratën bashkëngjitur si shtesë e deklaratës për masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe Rezolutës së saj A/RES 49/60 mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe deklaratën mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar bashkëngjitur asaj;

me dëshirën për forcimin e luftës kundër terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke kujtuar orientimet mbi të drejtat e njeriut dhe luftën kundër terrorizmit të aprovuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 11 korrik 2002;

duke ditur se për këtë qëllim do të ishte e përshtatshme të ndryshohej Konventa Europiane për shtypjen e terrorizmit (ETS Nr. 90) e hapur për nënshkrim në Strasburg më 27 janar 1977, që tani e tutje quhet “Konventa”;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme që të rishikohej lista e konventave ndërkombëtare në nenin 1 të Konventës dhe të parashikohej një procedurë e thjeshtëzuar për ta rishikuar atë si duhet;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme që të forcohej ndjekja e zbatimit të Konventës;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme të rishikohej regjimi i rezervave;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme të hapet Konventa për nënshkrim për të gjitha shtetet e interesuara,

kanë rënë dakord përsa vijon:

Neni 1

1. Paragrafi hyrës i nenit 1 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni. Te nënparagrafi b i këtij paragrafi, termi “nënshkroi” zëvendësohet nga termi “përfundoi” dhe nënparagrafët c, d , e dhe f të këtij paragrafi zëvendësohen nga nënparagrafët e mëposhtëm:

c) veprat penale brenda kuadrit të Konventës mbi parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, duke përfshirë agjentët diplomatikë të aprovuara në Nju Jork më 14 dhjetor 1973;

d) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve të aprovuara në Nju Jork më 17 dhjetor 1979;

e) veprat penale brenda Konventës mbi mbrojtjen fizike të materialeve nukleare, të aprovuara në Vjenë më 3 mars 1980;

f) veprat penale brenda kuadrit të protokollit të ndalimit të akteve të paligjshme të dhunës në aeroporte që i shërbejnë Aviacionit Ndërkombëtar Civil, bërë më Montreal më 24 shkurt 1988;

2. Paragrafi 1 i nenit 1 të Konventës plotësohet nga katër nënparagrafët e mëposhtëm:

g) veprat penale brenda kuadrit të Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së vozitjes në det, bërë në Romë më 10 mars 1988;

h) veprat penale brenda kuadri të protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë platformave të stacionuara në shtratin kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988;

i) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve terroriste, miratuar në Nju Jork më 15 dhjetor 1997;

j) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, miratuar në Nju Jork më 9 dhjetor 1999.

3. Teksti i nenit 1 të Konventës plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

2. Nëse nuk mbulohen nga konventat e renditura në paragrafin 1 për qëllimet e ekstradimit ndërmjet Shteteve Kontraktuese e njëjta gjë zbatohet jo vetëm për kryerjen e këtyre veprave penale kryesore si autor, por gjithashtu:

a) përpjekja për kryerjen e një prej këtyre veprave penale kryesore;

b) pjesëmarrja si bashkëpunëtor në kryerjen e një prej këtyre veprave penale kryesore ose përpjekja për kryerjen e çdonjëres prej tyre;

c) organizimi i kryerjes ose drejtimi i të tjerëve në kryerjen ose përpjekjen për të kryer njëren nga këto vepra penale kryesore.

Neni 2

Paragrafi 3 i nenit 2 të Konventës ndryshohet me përpilimin e mëposhtëm:

3. E njëjta zbatohet për:

a) tentativën për kryerjen e një prej veprave penale të lartpërmendura;

b) pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një nga veprat penale të sipërpërmendura ose në një tentativë për kryerjen e një vepre të tillë;

c) organizimin e kryerjes ose drejtimin e të tjerave në kryerjen ose përpjekjen për kryerjen e një prej veprave penale të sipërpërmendura.

Neni 3

1. Teksti i nenit 4 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni dhe shtohet një fjali e re në fund të këtij paragrafi si më poshtë: “Shtetet Palë marrin përsipër t'i konsiderojnë këto vepra penale si vepra të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi të lidhur më vonë ndërmjet tyre.”.

2. Teksti i nenit 4 të Konventës plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“2. Kur një Shtet Palë që kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin nuk ka një marrëveshje të tillë, Shteti Palë i kërkuar, në çmimin e tij, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me veprat penale të përmendura në nenet 1 ose 2.”

Neni 4

1. Teksti i nenit 5 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni.

2. Teksti i nenit 5 të Konventës plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

“2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk interpretohet sikur i cakton shtetit të kërkuar një detyrim për ekstradim, nëse personi i kërkuar për t’u ekstraduar rrezikon t’i nënshtrohet torturës.

3. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk interpretohet sikur i cakton shtetit të kërkuar një detyrim për ekstradim, nëse personi i kërkuar për t’u ekstraduar rrezikon t’i nënshtrohet dënimit me vdekje, ose kur ligji i shtetit të kërkuar nuk lejon dënimin me burgim të përjetshëm, burgimit të përjetshëm pa pasur të drejtën e lirimit me kusht, përveç kur në bazë të marrëveshjeve të zbatueshme për ekstradimin shteti i kërkuar është i detyruar të bëjë ekstradimin, nëse Shteti kërkuar nuk jep garanci të tilla që konsiderohen nga shteti i kërkuar të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do të jepet ose nëse jepet nuk do të zbatohet ose personi në fjalë nuk do t’i nënshtrohet dënimit me burgim të përjetshëm pa iu dhënë mundësia e lirimit me kusht.”

Neni 5

Shtohet një nen i ri pas nenit 8 të Konventës, me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 9

Shtetet Palë mund të lidhin ndërmjet tyre marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për të plotësuar dispozitat e kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në të.”

Neni 6

1. Neni 9 i Konventës bëhet neni 10.

2. Paragrafi 1 i nenit 10 të ri ndryshohet me përpilimin e mëposhtëm:

“Komiteti European për problemet e krimit (KEPK) është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Konventës. KEPK:

a) mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e Konventës;

b) bën propozime me qëllim që të lehtësojë ose të përmirësojë zbatimin e Konventës;

c) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave, në lidhje me propozimet për ndryshime të Konventës dhe jep mendimin e vet mbi çdo propozim për ndryshimet e Konventës së paraqitur nga një Shtet Palë në pajtim me nenet 12 dhe 13;

d) me kërkesë të një Shteti Palë, shpreh mendimin e vet për çdo çështje në lidhje me zbatimin e Konventës;

e) bën çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje me mirëkuptim për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i Konventës;

f) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave, në lidhje me shtetet joanëtare të Këshillit të Europës për t’i ftuar të aderojnë në Konventë në pajtim me nenin 14 paragrafi 3;

g) i paraqet çdo vit Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi ndjekjen e parashikuar në këtë nen mbi zbatimin e Konventës.

3. Fshihet paragrafi 2 i nenit 10 të ri.

Neni 7

1. Neni 10 i Konventës bëhet neni 11.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit 11 të ri, fjalët "Neni 9 paragrafi 2" zëvendësohen me fjalët “Neni 10 e, ose bisedime”. Në fjalinë e dytë të këtij paragrafi, fjala “dy” fshihet. Fjalitë e tjera të këtij paragrafi fshihen.

3. Paragrafi 2 i nenit 11 të ri bëhet paragrafi 6 i këtij neni. Fjalja “Kur nuk mund të krijohet një shumicë, arbitri ka të drejtën e votës vendimtare” shtohet pas fjalisë së dytë dhe në fjalinë e fundit fjalët “Vendimi i tij” zëvendësohet me fjalët “Vendimi i gjykatës”.

4. Teksti i nenit 11 të ri plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

“2. Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet Palëve, që janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, kur një Palë nuk emëron një arbitër në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni brenda tre muajve nga kërkesa për arbitrazh, një arbitër emërohet nga Presidenti i Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut me kërkesë të Palës tjetër.

3. Në rastin e mosmarrëveshjes ku përfshihet një Palë që nuk është shtet anëtar i Këshillit të Europës, kur një Palë nuk emëron një arbitër në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni brenda tre muajve nga kërkesa për arbitrazh, një arbitër emërohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë të Palës tjetër.

4. Në rastet e rregulluara nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, kur presidenti i Gjykatës përkatëse është shtetas i një prej Palëve në mosmarrëveshje, kjo detyrë kryhet nga zëvendës-presidenti i Gjykatës, dhe kur zëvendës-presidenti është shtetas i një prej Palëve në mosmarrëveshje, nga gjyqtari më i vjetër i Gjykatës që nuk është shtetas i ndonjë prej palëve në mosmarrëveshje.

5. Procedurat e parashikuara në paragrafët 2 ose 3 dhe 4 të mësipërm, zbatohet *mutatis mutandis* kur arbitrat nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e një arbitri në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 8

Shtohet një nen i ri pas nenit të ri 11 me përpilimin e mëposhtëm:

“Neni 12

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Shtet Palë ose nga Komiteti i Ministrave. Propozimet për ndryshime u dërgohen Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Shtetet Palë joanëtare, kur është e nevojshme me KEPK-në, Komiteti i Ministrave mund të aprovojë një ndryshim në pajtim me shumicën e parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u paraqet Shteteve Palë për pranim çdo ndryshim.

3. Çdo ndryshim i pranuar në pajtim me paragrafin e mësipërm hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm nga Palët për pranimin e tij.”

Neni 9

Shtohet një nen i ri pas nenit të ri 12 me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 13

1. Për të rishikuar listën e traktateve të nenit 1 paragrafi 1, ndryshimet mund të propozohen nga Shtetet Kontraktuese ose nga Komiteti i Ministrave. Këto propozime për ndryshime kanë të bëjnë vetëm me traktate që janë miratuar brenda Organizatës së Kombeve të Bashkuara që rregullojnë në mënyrë specifike terrorizmin ndërkombëtar dhe që kanë hyrë në fuqi. Ato u njoftohen Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Shtetet Palë joanëtare, dhe kur është e nevojshme me KEPK-në, Komiteti i Ministrave mund të miratojë një ndryshim të propozuar nga shumica e parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës. Ndryshimi hyn në fuqi pas kalimit të një periudhe një vjeçare pas datës në të cilën ai u është paraqitur Shteteve Palë. Gjatë kësaj periudhe, çdo Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo kundërshtim për hyrjen në fuqi të ndryshimit në këtë aspekt.

3. Kur një e treta e Shteteve Palë njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm për një kundërshtim për hyrjen në fuqi të një ndryshimi, ky ndryshim nuk hyn në fuqi.

4. Kur njoftimi për një kundërshtim bëhet nga më pak se një e treta e Shteteve Palë, ky ndryshim hyn në fuqi për ato Shtete Palë që nuk kanë njoftuar kundërshtimin.

5. Kur një ndryshim hyn në fuqi në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni dhe një Shtet Palë ka njoftuar një kundërshtim për të, ky ndryshim hyn në fuqi për këtë Shtet Palë në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën ai ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për pranimin e tij.”

Neni 10

1. Neni 11 i Konventës bëhet neni 14.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit 14 fjalët “Shtetet anëtare të Këshillit të Europës” zëvendësohen me fjalët “Shtetet anëtare dhe shtetet vëzhguese të Këshillit të Europës” zëvendësohet me fjalët dhe në fjalinë e dytë dhe të tretë, fjalët “ose miratimi” zëvendësohen me termat “miratimi ose aderimi”.

3. Teksti i nenit 14 të ri plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“3. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, pas konsultimit me KEPK-në mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Europës, të ndryshëm nga ata që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, të aderojnë në Konventë. Vendimi merret me anë të shumicës së parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës dhe nga vota unanime e përfaqësuesve të Shteteve Palë që kanë të drejtë të jenë në Komitetin e Ministrave.”

4. Paragrafi 3 i nenit të ri 14 bëhet paragrafi 4 i këtij neni dhe fjalët “ose miraton” dhe “ose miratimit” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “miraton ose aderon” dhe “miratim ose aderim”.

Neni 11

1. Neni 12 i Konventës bëhet neni 15.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit të ri 15, fjalët “ose miratimit” zëvendësohen me fjalët “miratimit ose aderimit”.

3. Në fjalinë e parë të paragrafit 2 të nenit të ri 15, fjalët “ose miratimit” zëvendësohen me fjalët “miratimit ose aderimit”.

Neni 12

1. Rezervat që i janë bërë Konventës para hapjes për nënshkrim të këtij protokollit nuk zbatohen për Konventën e ndryshuar nga ky protokoll.

2. Neni 13 i Konventës bëhet neni 16.

3. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit të ri 16 fjalët “Palë në Konventë me [data e hapjes për nënshkrimin e protokollit që ndryshon Konventën]” shtohen para fjalës “mund” dhe fjalët “e protokollit që ndryshon Konventën” shtohen pas fjalës “miratim”. Shtohet një fjali e dytë pas fjalëve “motive politike” me këtë përpilim: “Shtetet Palë marrin përsipër t’a zbatojnë këtë rezervë me bazë rast pas rasti, me një vendim të arsyetuar rregullisht dhe, gjatë vlerësimit të karakterit të veprës penale, duke marrë parasysh çdo aspekt veçanërisht serioz të saj, duke përfshirë:”. Pjesa tjetër e fjalisë fshihet me përjashtim të nënparagrafëve a, b, dhe c.

4. Teksti i nenit të ri 16 plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“2. Kur zbaton paragrafin 1 të këtij neni, një Shtet Palë tregon veprat penale për të cilat zbatohet rezerva e tij.”

5. Paragrafi 2 i nenit të ri 16 bëhet paragrafi 3 i këtij neni. Në fjalinë e parë të këtij paragrafi termi “Palë” shtohet para fjalës “Shtet” dhe fjalët “paragrafi i mësipërm” zëvendësohet me fjalët “paragrafi 1”.

6. Paragrafi 3 i nenit të ri 16 bëhet paragrafi 4 i këtij neni. Në fjalinë e parë të këtij paragrafi termi “Palë” shtrohet para fjalës “Shtet”.

7. Teksti i nenit të ri 16 plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

“5. Rezervat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni qëndrojnë në fuqi për një periudhë trivjeçare nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj Konvente në lidhje me shtetin përkatës. Megjithatë këto rezerva mund të rinovohen me afate kohore të njëjta.

6. Dymbëdhjetë muaj para datës së shfuqizimit të rezervës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton në lidhje me këtë Shtetin Palë përkatës. Jo më vonë se tre muaj para shfuqizimit, Shteti Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai mban në fuqi ndryshon ose tërheq rezervën. Kur një Shtet Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai e mban në fuqi rezervën, ai jep një shpjegim në lidhje me arsyet që justifikojnë

vazhdimin. Në mungesë të njoftimit nga Shteti Palë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës e njofton atë Shtet Palë se rezerva e tij konsiderohet të jetë zgjatur automatikisht për një periudhë gjashtëmuajore. Kur ky Shtet Palë nuk e bën të ditur synimin e tij për mbajtjen në fuqi ose ndryshimin e rezervës para kalimit të këtij afati, kjo bën që rezerva të humbë fuqinë.

7. Kur një Shtet Palë, pas marrjes së një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, nuk ekstradon një person në zbatim të një rezerve bërë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ai ua paraqet çështjen pa përjashtim dhe pa asnjë vonesë të panevojshme organeve të tij kompetente për qëllimin e ndjekjes penale, përveç kur shteti kërkues dhe shteti i kërkuar bien dakord ndryshe. Organet kompetente, për qëllimin e ndjekjes penale në shtetin e kërkuar, e marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e një veprë penale e një natyre serioze sipas ligjit të atij shteti. Shteti i kërkuar ua njofton rezultatin përfundimtar të gjyqimit pa ndonjë vonesë të panevojshme shtetit kërkues dhe Sekretari i Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të cilët ia paraqesin konferencës së parashikuar në nenin 17.

8. Vendimi i refuzimit të kërkesës për ekstradim mbi bazën e një rezerve, bërë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, i paraqitet menjëherë shtetit kërkues. Nëse brenda një kohe të arsyeshme në shtetin e kërkuar nuk është marrë asnjë vendim gjyqësor mbi thelbin e çështjes në pajtim me paragrafin 7, shteti kërkues mund t'ia njoftojë këtë fakt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili ia paraqet çështjen Konferencës së parashikuar në nenin 17. Kjo konferencë e merr çështjen në shqyrtim dhe lëshon një opinion në lidhje me përputhjen e refuzimit me Konventën dhe ia paraqet atë Komitetit të Ministrave për qëllimin e lëshimit të një deklarate mbi këtë çështje. Gjatë kryerjes së funksioneve sipas këtij paragrafi, Komiteti i Ministrave e zhvillon mbledhjen me përbërje të kufizuar të Shteteve Palë."

Neni 13

Shtohet një nen i ri pas nenit 16 të ri të Konventës me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 17

1. Pa ndikuar në zbatimin e nenit 10, një konferencë e Shteteve Palë kundër terrorizmit (tani e tutje quhet "COSTER") është e përgjegjshme për të siguruar:

a) përdorimin dhe operimin e efektshëm të kësaj Konvente duke përfshirë indentifikimin e çdo problemi për këtë, në lidhje të ngushtë me KEPK-në;

b) shqyrtimin e rezervave të bëra më pajtim me nenin 16 dhe veçanërisht procedurën e parashikuar në nenin 16 paragrafi 8;

c) shkëmbimin i informacionit mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore dhe politike në lidhje me luftën kundër terrorizmit;

d) shqyrtimin, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, të masave të miratuara brenda Këshillit të Europës në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe, kur është e përshtatshme, përpilimin e propozimeve për masa shtesë që janë të nevojshme për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe kur bëhet fjalë për bashkëpunimin për çështje penale, në konsultim me KEPK-në;

e) përgatitjen e mendimeve në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe zbatimin e kushteve të referencës të dhëna nga Komiteti i Ministrave.

2. COSTER-i përbëhet nga një ekspert i emëruar nga secili Shtet Palë. Ai i zhvillon takimet një herë në vit rregullisht dhe përjashtimisht me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës ose të paktën e një të tretës së Shteteve Palë.

3. COSTER-i miraton rregullat e veta procedurale. Shpenzimet për pjesëmarrjen e Shteteve Palë që janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, mbulohen nga Këshilli i Europës. Sekretariati i Këshillit të Europës ndihmon COSTER-in për kryerjen e funksioneve të tij në pajtim me këtë nen.

4. KEPK-ja informohet periodikisht në lidhje me punën e COSTER-it.

Neni 14

Neni 14 i Konventës bëhet neni 18.

Neni 15

Neni 15 i Konventës fshihet.

Neni 16

1. Neni 16 i Konventës bëhet neni 19.
2. Në fjalinë hyrëse të nenit të ri 19, fjalët “Shtetet anëtare të Këshillit” zëvendësohet me fjalët “Shtetet Palë”.
3. Në paragrafin b të nenit të ri 19, fjalët “ose miratim” zëvendësohen me fjalët “miratim ose aderim”.
4. Në paragrafin c të nenit të ri 19, numri “11” bëhet “14”.
5. Në paragrafin d të nenit të ri 19, numri “12” bëhet “15”.
6. Paragrafët e dhe f të nenit të ri 19 fshihen.
7. Paragrafi g i nenit të ri 19 bëhet paragrafi e i këtij neni dhe numri “14” bëhet “18”.
8. Paragrafi h i nenit të ri 19 fshihet.

Neni 17

1. Ky protokoll është i hapur për t’u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkruese të Konventës, të cilat mund të shprehin pëlqimin e tyre se marrin përsipër detyrimin nëpërmjet:
 - a) nënshkrimit pa rezervë për ratifikimin, pranimin ose miratimin;
 - b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimin ose miratimit që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.
2. Instrumentet e ratifikimit, pranimin ose miratimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshilli të Europës.

Neni 18

Ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe trimujore pas datës në të cilën të gjitha Palët e Konventës kanë shprehur pëlqimin e tyre se marrin përsipër detyrimet e këtij protokoll, në pajtim me dispozitat e nenit 17.

Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u njofton shteteve anëtare të Këshillit të Europës:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin i instrumenteve të ratifikimit, të pranimin ose të miratimit;
- c) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në pajtim me nenin 18;
- d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë protokoll.

Si dëshmi i kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg më/...., në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme të cilat depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshilli të Europës u dërgon të gjitha shteteve nënshkruese kopje të vërtetuara.

LIGJ
Nr.9232, datë 13.5.2004

PËR PROGRAMET SOCIALE PËR STREHIMIN E BANORËVE TË ZONAVE URBANE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe juridiksioni

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

2. Ky ligj e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin nën juridiksionin e bashkive të Republikës së Shqipërisë, ndërsa për territorin nën juridiksionin e komunave do të zgjidhet me një ligj të veçantë.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Strehim" është tërësia e elementeve financiare, sociale dhe institucionale të procesit të sigurimit të banesës.

2. "Banesë" është bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm, që ka hyrje të pavarur (derë) nga rruga, kati, oborri dhe tarraca e destinuar për t'u banuar nga një ose disa familje.

3. "Programe sociale strehimi" janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore.

4. "Aftësi paguese" është tërësia e mjeteve financiare, që një familje mund t'ia kushtojë pagesës së qirave ose të kësteve të kredive, në raport me të ardhurat familjare, në masën e përcaktuar në këtë ligj.

5. "Kontratë qiraje sociale" është një kontratë qiraje, ku niveli i qirasë kontrollohet nga shteti.

6. "Qiramarrës" është individ ose familja, e cila banon me kontratë qiraje sociale.

7. "Normë e strehimit" është koeficienti që shpreh sipërfaqen minimale të banimit, që duhet të ketë një individ në banesë. Ky koeficient shprehet në m²/person.

8. "Qira minimale e banesave në treg" është qiraja mesatare e grupit të parë të 10 grupeve të qirave, me të cilat janë dhënë me qira apartamentet në tregun e lirë, për një vit, e shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi.

9. "Çmim minimal i banesave në treg" është çmimi mesatar i grupit të parë të 10 grupeve të çmimeve, me të cilat janë shitur apartamentet në tregun e lirë, për një vit, i shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi.

10. "Sektor privat" është tërësia e personave juridikë ose fizikë privatë, që veprojnë në ndërtimin e banesave dhe në prodhimin e materialeve të ndërtimit.

11. "Organizata jofitimprurëse" janë organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të banesave sociale me qira.

12. "Kredi me kushte lehtësuese" janë ato kredi, interesat e të cilave subvencionohen nga shteti.

13. "Ent menaxhues" është personi juridik ose fizik, që merret me administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale të dhëna me qira dhe të bonusit të strehimit.

14. "Institucion që menaxhon kredinë" është banka ose institucioni financiar, i cili ka nënshkruar një kontratë me shtetin për menaxhimin e një programi kreditimi, me kushte lehtësuese, në sektorin e strehimit.

15. "Kredi hipotekore" janë hua që jepen për strehim, të cilat sigurohen nëpërmjet hipotekimit të një pasurie të paluajtshme, zakonisht me afat të gjatë maturimi dhe interesa më të ulët se kreditë tregtare.

16. "Bonus strehimi" është dokumenti që përcakton një shumë të hollash, që i takojnë një familjeje, si ndihmë nga shteti, për të mbuluar pjesërisht pagesën e qirave.

KREU II

KRITERET E PËRCAKTIMIT TË PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 3

Klasifikimi i programeve sociale të strehimit

Programet sociale të strehimit klasifikohen si më poshtë:

1. Programe të banesave sociale me qira, në të cilat përfshihen:

a) banesat, që ndërtohen apo blihen nga tregu i lirë nga bashkitë ose organizatat jofitimprurëse, të cilat jepen me kontratë qiraje sociale;

b) banesat ekzistuese, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilat janë klasifikuar nga organet e qeverisjes vendore apo nga organizatat jofitimprurëse si banesa sociale, që mund të jepen me qira për familjet që përfitojnë bonus strehimi;

c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të bashkive dhe janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, në përputhje me planin rregullues urbanistik.

2. Programe të banesave me kosto të ulët.

3. Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Neni 4

Përcaktimi i familjeve, që përfitojnë nga programet sociale të strehimit

1. Familjet, që klasifikohen për t'u trajtuar me programe sociale të strehimit, miratohen me vendim të këshillit bashkiak, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje;

c) kanë mbetur të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Përfshihen në një nga shkronjat "a", "b" dhe "c" vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji.

2. Administrimi i kërkesave për programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga organet e qeverisjes vendore.

3. Dokumentacioni që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar në banesa sociale me qira dhe afatet e procedurat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Normat e strehimit, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

Trajtohen me përparësi individët ose familjet që plotësojnë kushtet e nenit 4 pika 1 dhe që kanë këto specifika:

- a) familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore";
- b) familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar;
- c) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;
- ç) të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesit shoqëror;
- d) individët me aftësi të kufizuar, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë, të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, të invalidit të punës dhe të invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare;
- dh) familjet me shumë fëmijë;
- e) çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç;
- ë) familjet që kanë ndryshuar vendbanimin për efekt punësimi;
- f) individët me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga jetimore ose nga qendrat e përkujdesit e deri në moshën 30 vjeç.

KREU III

BANESAT SOCIALE ME QIRA

Neni 6

Përcaktimi i kufijve të të ardhurave

1. Kufijtë minimalë dhe maksimalë të të ardhurave të familjeve, që përfitojnë banesa sociale me qira, sipas strukturës së familjes, përcaktohen nga entet menaxhuese, sipas lidhjes "A", që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Entet menaxhuese, për përcaktimin e këtyre kufijve, bazohen:

- a) në vlerën e banesave të ndërtuara ose të blera në tregun e lirë nga entet menaxhuese;
- b) në aftësinë paguese të familjes, nivel i pranueshëm i së cilës merret pagesa e qirasë mujore, e cila nuk duhet të kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes;
- c) në të ardhurat e familjes, të cilat, pas pagesës së qirasë, nuk bien më poshtë se niveli i plotë i ndihmës ekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Nga ky kusht përjashtohen rastet e parashikuara në shkronjat "d" dhe "f" të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 7

Ndërtimi i banesave sociale

Çdo bashki parashikon në territorin nën juridiksionin e vet sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri të mjaftueshëm banesash sociale me qira, bazuar në numrin e popullsisë dhe në përbërjen, sipas grupeve sociale të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 8

Blerja e banesave sociale në treg

Në rastet kur vlera e banesave në tregun e lirë është më e ulët se vlera e ndërtimit të banesave të reja, mbi bazën e vendimit të këshillit bashkiak, entet menaxhuese blejnë banesa nga tregu i lirë, për t'i dhënë më pas me kontratë qiraje sociale. Kushtet, normat dhe standardet, që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qira

1. Mënyra e administrimit dhe e mirëmbajtjes së banesave sociale me qira përcaktohet nga këshilli bashkiak. Banesat me qira, si rregull, administrohen nga entet menaxhuese të licencuara. Licencimi i enteve menaxhuese bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Entet menaxhuese kryejnë mirëmbajtjen e banesave sociale me qira vetë ose nëpërmjet kontraktimit të ndërmarrjeve të specializuara, të cilat duhet të jenë të licencuara.

Neni 10

Lidhja e kontratës së qirasë

1. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet entit menaxhues dhe familjes, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, me të drejtë rinovimi çdo vit, bazuar në dokumentin zyrtar që vërteton të ardhurat e çdo individi të familjes nga qendra e punës ose personi juridik apo fizik që e ka punësuar, ose zyra përkatëse e ndihmës sociale pranë bashkisë, ose Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe në deklaratën noteriale për të ardhurat e tjera të familjes, të bërë nga kryefamiljari. Në të ardhurat e tjera të familjes hyjnë të ardhurat nga dypunësimi, emigracioni, prona të paluajtshme dhe trashëgimia.

2. Nëse familja siguron një banesë tjetër, ajo detyrohet të bëjë njoftimin e menjëhershëm pranë entit menaxhues, nga i cili ka përfituar banesën me kontratë qiraje sociale. Afati i njoftimit për lirim e banesës përcaktohet nga enti menaxhues, si palë kontraktuese, sipas dispozitave të përgjithshme të kontratës tip, e cila miratohet nga ministri që mbulon fushën e strehimit.

Neni 11

Përcaktimi i qirasë

1. Këshillat bashkiakë miratojnë çdo vit masën e qirasë vjetore për banesat sociale me qira, të shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi. Qiraja mbulon kostot e administrimit dhe të mirëmbajtjes dhe taksën mbi pasurinë e paluajtshme. Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan për të gjitha shërbimet e tjera që lidhen me shfrytëzimin e banesës. Këshilli bashkiak miraton rregulloren për shfrytëzimin e banesave sociale me qira nga qiramarrësit, ku përcaktohen, me hollësi, të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit dhe të entit menaxhues.

2. Masa e qirasë vjetore nuk duhet të jetë më e madhe se 4 për qind e kostos së ndërtimit të banesës nga shteti, për banesat e reja, apo 4 për qind e vlerës së banesës të blerë në treg.

3. Për objektet e dala jashtë funksionimit dhe ato të kthyera në fond banesash sociale me qira, sipas përcaktimit të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat bashkiakë, sipas pikës 2 të këtij neni, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.

Neni 12

Zgjidhja e kontratës së qirasë

Enti menaxhues zgjidh kontratën e qiramarrjes kur:

a) qiramarrësi bën deklarin të rremë për të ardhurat;

b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;

c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti apartamentin e marrë me qira nga enti menaxhues.

Pas zgjidhjes së kontratës qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirim e banesës. Në të kundërt enti menaxhues njofton autoritetet e policisë së bashkisë, të cilat janë të detyruara të realizojnë lirim e banesës.

KREU IV BONUSET E STREHIMIT

Neni 13

Rastet e përdorimit të bonusit të strehimit

Entet menaxhuese në qytet, që kanë treg banesash me qira, në bazë të vendimit të këshillit bashkiak, i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, bonus strehimi kur:

- a) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më e kushtueshme;
- b) nuk zotërohen fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg;
- c) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qendrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera.

Neni 14

Administrimi i bonusit të strehimit

1. Bonusi i strehimit jepet me miratimin e këshillit bashkiak, në përputhje me buxhetin që jepet çdo vit për subvencionimin e qirave, sipas nenit 24 të këtij ligji dhe bazuar në kriteret që duhet të plotësojë familja për të përfituar ndihmën e shtetit, sipas këtij ligji.

2. Përmbajtja e bonusit të strehimit përcaktohet me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e strehimit.

Neni 15

Përcaktimi i vlerës së bonusit të strehimit

Vlera e bonusit të strehimit nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e qirasë minimale të banesave në tregun e lirë, për bashkinë ku jepet ky bonus. Vlera maksimale përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm dhe miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Pagesa, që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së bonusit, nuk duhet t'i kalojë 30 për qind të të ardhurave të familjes. Mënyra e llogaritjes së vlerës së bonusit të strehimit jepet në lidhjen "B", që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 16

Vlefshmëria e bonusit të strehimit

1. Familja, që përfiton bonus strehimi, duhet të lidhë kontratë qiraje brenda tre muajve nga data e lëshimit të bonusit.

2. Bonusi rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruara të familjes, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

3. Bonusi e humbet vlefshmërinë kur kontrata zgjidhet sipas përcaktimit të nenit 12 të këtij ligji ose kur skadon afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

KREU V

BANESAT ME KOSTO TË ULËT

Neni 17

Ndërtimi

1. Banesat me kosto të ulët ndërtohen me fondet e Buxhetit të Shtetit, me fondet e bashkisë dhe nga donacionet private.

2. Çmimi i shitjes së banesave me kosto të ulët përcaktohet në bazë të vlerës së objektit që ndërtohet. Vlera e objektit përcaktohet në bazë të koston së ndërtimit të banesës, çmimit të tokës, koston së infrastrukturës, vlerës së projektit dhe shpenzimeve për administrimin e procesit dhe të shpërndarjes.

3. Normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Kategorizimi i familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët

1. Familjet që klasifikohen për t'u trajtuar me banesa me kosto të ulët janë:

a) familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë nuk kanë në pronësi një banesë;

b) familjet, që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;

c) familjet, që kanë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji.

2. Normat e strehimit, sipas shkonjës "b" të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga zyrat përkatëse të bashkive.

Neni 19

Përcaktimi i kufijve të të ardhurave

1. Kufijtë minimalë dhe maksimalë të të ardhurave të familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët, sipas strukturës së familjes, përcaktohen nga këshilli bashkiak, sipas formulës së dhënë në lidhjen "C", që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Për përcaktimin e këtyre kufijve këshillat bashkiakë bazohen:

a) në vlerën e banesës së ndërtuar ose të blerë në treg;

b) në aftësinë paguese të familjes, nivel i pranueshëm i së cilës merret pagesa e kësteve mujore të kredisë, e cila nuk duhet t'i kalojë 35 për qind të të ardhurave të familjes;

c) në të ardhurat e familjes, të cilat, pas pagesës së kësteve të kredisë, nuk duhet të bien më poshtë se niveli i plotë i ndihmës ekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Kufiri minimal i të ardhurave të familjes është sa trefishi i kësteve mujore të kredisë së subvencionuar dhe kufiri maksimal i të ardhurave mujore të familjes është sa trefishi i pagesës mujore të kredisë së pasubvencionuar nga shteti.

Neni 20

Kufizimet

1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një person tjetër, apo ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

2. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer atë, duke u bërë pronarë e saj, detyrohet të mos e shesë për një periudhë 15-vjeçare. Kur familja, për arsye të ndryshme, kërkon ta shesë banesën brenda këtij afati, ajo detyrohet t'ia shesë këtë banesë subjektit, të cilit ia ka blerë dhe me vlerë jo më shumë sesa vlera me të cilën është blerë.

KREU VI

PROGRAMET E PAJISJES SË TRUALLIT ME INFRASTRUKTURË

Neni 21

Planifikimi

Zyrat përkatëse të bashkisë, në bazë të përcaktimit të zonave të banimit, studimeve urbanistike, vlerësimit të nevojave për strehim dhe kërkesave për ndërtim banesash, bëjnë pajisjen e truallit me infrastrukturën e nevojshme për ndërtimin e banesave. Pajisja e truallit me infrastrukturë përfshin investimet për rrjetin kryesor dhe dytësor të ujësjellësit, kanalizimet, rrjetin elektrik dhe telefonik. Programet e pajisjes së truallit me infrastrukturë realizohen në troje, që janë pronë publike.

Neni 22

Qëllimi

1. Pajisja e truallit me infrastrukturë, në varësi të vendndodhjes, çmimit dhe pronësisë së tij, bëhet për qëllime sociale ose për t'u shitur në treg. Në rastin kur ato i shiten sektorit privat për qëllime tregu, të ardhurat e krijuara përdoren nga bashkitë për programe sociale strehimi. Çmimi i shitjes së truallit të pajisur me infrastrukturë përcaktohet në bazë të vlerave të tregut të lirë dhe miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Procedurat e shitjes së truallit të pajisur me infrastrukturë për qëllime tregu, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Trualli i pajisur me infrastrukturë, i paracaktuar për programe sociale, u shitet subjekteve të sektorit privat, që janë të interesuara të ndërtojnë banesa me kosto të ulët, ose u jepet atyre me kontratë qiraje financiare (leasing), sipas procedurave të Kodit Civil.

3. Trualli i pajisur me infrastrukturë, së bashku me lejen e ndërtimit mund t'i shitet familjes, e cila me të ardhurat që ka nuk e përballon blerjen e banesës me kosto të ulët, për të ndërtuar vetë banesën, sipas përcaktimeve të bëra në studimin urbanistik të zonës.

4. Procedurat e shitjes së truallit së pajisur me infrastrukturë familjeve apo individëve, për ndërtim banesash, përcaktohen nga ministria që mbulon fushën e strehimit.

5. Programet e pajisjes së truallit me infrastrukturë financohen dhe menaxhohen nga bashkitë.

Neni 23

Kategorizimi i familjeve, që përfitojnë truall të pajisur me infrastrukturë

Familjet që klasifikohen për t'u trajtuar me truall të pajisur me infrastrukturë janë:

- a) familjet që, në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë, nuk kanë në pronësi një banesë;
- b) familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
- c) familjet, të ardhurat e të cilave nuk përballojnë blerjen e banesës me kosto të ulët.

KREU VII

NDIHMA E SHTETIT

Neni 24

Subvencionimi i qirasë

1. Për familjet, të cilat nuk kanë mundësi financiare për të kryer pagesën e qirasë dhe që nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" të nenit 6 të këtij ligji, shteti subvencionon deri në 50 për qind të masës së qirasë që duhet të paguajë familja. Subvencionimi jepet vetëm pas verifikimit të gjendjes ekonomike të familjes, sipas nenit 28 të këtij ligji.

2. Për rastet e përcaktuara në shkronjat "d" dhe "f" të nenit 5 të këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar në shkronjën "c" të nenit 6 të këtij ligji, masa e subvencionit mund të jetë jo më shumë se 75 për qind.

3. Subvencionimi i qirasë, që përfiton çdo familje, bëhet nga të ardhurat e vetë bashkive dhe me miratimin e këshillit bashkiak. Bashkitë e nivelit jo të parë, që nuk arrijnë të realizojnë të ardhura të mjaftueshme, financohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 25

Subvencionimi i interesave të kredive

1. Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore, me kushte lehtësuese, nga një institucion financiar që ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave për menaxhimin e kredive. Kushtet e dhënies nga bankat të kredisë për familjet përcaktohen me marrëveshje të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën e strehimit dhe institucionit që jep dhe menaxhon kredinë.

2. Ndihma e shtetit jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 19 të këtij ligji. Masa e subvencionimit të interesave të kredisë jepet sipas aftësisë pagueuse të familjes dhe përcaktohet nga Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin që mbulon fushën e strehimit.

3. Masa e subvencionit, që rezulton në fund të periudhës së maturimit të kredisë, nuk duhet të kalojë më shumë se 100 për qind të vlerës së banesës. Në rast se nga llogaritjet rezulton një subvencion më i madh për përbalimin e kësteve të kredisë, familja përzgjidhet për t'u trajtuar me banesë sociale me qira ose me truall të pajisur me infrastrukturë, ku familja mund të ndërtojë vetë banesën.

Neni 26

Asistenca teknike

Familjet që përfitojnë truall të pajisur me infrastrukturë, për të ndërtuar vetë banesën e tyre, ndihmohen me asistencë teknike nga punonjës të specializuar që paguhën nga bashkitë.

Neni 27

Përparësitë në përzgjedhjen për të përfituar ndihmën e shtetit

Përparësi në marrjen e ndihmës kanë:

- a) familjet me shumë fëmijë;
- b) familjet që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të shkronjës "d" të nenit 5 të këtij ligji;
- c) familjet ku kryefamiljari është grua;
- ç) bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në ngarkim fëmijët;
- d) individët me statusin e jetimit, sipas shkronjës "f" të nenit 5 të këtij ligji.

KREU VII

VERIFIKIMI I GJENDJES EKONOMIKE DHE SOCIALE TË FAMILJES

Neni 28

Mënyra e verifikimit

1. Ndihma e shtetit bazohet në verifikimin e gjendjes ekonomike e financiare të familjes.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë të zyrave të ndihmës ekonomike, sipas procedurave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon fushën e strehimit dhe të ministrit që mbulon çështjet sociale.

Neni 29
Ankimimi

Pas verifikimit nga administratorët shoqërorë, zyrat përkatëse të bashkisë njoftojnë zyrtarisht familjen për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike. Kundër vendimit të administratorëve, familja ka të drejtë të ankohet pranë këshillit bashkiak brenda 10 ditëve dhe të kërkojë një rivlerësim të dytë. Vendimi i rivlerësimit jepet nga këshilli bashkiak dhe është i formës së prerë. Në vendim përcaktohet forma e strehimit të familjes.

KREU IX
FINANCIMI I PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 30
Burimet e financimit të programeve sociale të strehimit

Programet sociale të strehimit financohen nga:

- a) fondet buxhetore, që jepen çdo vit për programe strehimi nëpërmjet ministrisë që mbulon fushën e strehimit;
- b) kontributet nga donatorë të ndryshëm;
- c) të ardhurat që krijohen nga taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme;
- ç) të ardhurat nga veprimtaritë fitimprurëse të bashkive, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 31
Programet 10-vjeçare të strehimit

Zyrat përkatëse të bashkive hartojnë programe 10-vjeçare të strehimit për popullsinë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, të cilat miratohen nga këshillat bashkiakë.

Këto programe përmbajnë:

- a) burimet e financimit, që zotërohen nga Buxheti i Shtetit, brenda një viti financiar, fondet e siguruara nga vetë bashkia, si dhe fonde nga burime të tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;
- b) nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve, sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;
- c) lidhjet e këtij programi me programe të tjera të bashkisë dhe mënyrën e ndikimit të tyre te njëra-tjetra;
- ç) numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira;
- d) numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;
- dh) pajisjen e truallit me infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve.

Neni 32
Kriteret e planifikimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit

Bazuar në planet 10-vjeçare të bashkive, bëhet planifikimi vjetor i Buxhetit të Shtetit, në zbatim të programeve të hartuara në bazë të këtij ligji. Për hartimin e planit të buxhetit merren parasysh këta faktorë:

- a) përqendrimi i popullsisë në shkallë vendi;
- b) përqendrimi i familjeve në nevojë për strehim;
- c) përqendrimi i familjeve të varfra;
- ç) përparësitë e zhvillimit ekonomik të vendit.

Neni 33
Mënyra e planifikimit

Fondet e Buxhetit të Shtetit, për çdo program, ndahen në:

1. Fonde për banesa sociale me qira, që përfshijnë:
 - a) fonde për investime;
 - b) subvencion për mbulimin e qirave, sipas nenit 24 të këtij ligji.
2. Fonde për banesa me kosto të ulët, që përfshijnë:
 - a) fonde për investime;
 - b) fonde për subvencione për mbulimin e interesave të kredisë, sipas nenit 25 të këtij ligji.
3. Fonde për blerje trualli për programe strehimi në ndihmë të bashkive të nivelit jo të parë.
4. Fonde për asistencë teknike të paracaktuara për organizimin e studimeve, trajnimeve të administratës së bashkive, si dhe për asistencë teknike për familjet që kërkojnë ta ndërtojnë vetë banesën, sipas nenit 26 të këtij ligji.

KREU X
**ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE AFATET E NGRITJES SË KAPACITETEVE PËR
ZBATIMIN E KËTJ LIGJI**

Neni 34
Komiteti Kombëtar për Strehimin

1. Për drejtimin dhe bashkërendimin e punës, në zbatim të këtij ligji, ngrihet Komiteti Kombëtar i Strehimit, me atributet e një organi këshillimor pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit.

2. Komiteti Kombëtar për Strehimin, bazuar në gjykimin konsultativ me strukturat përkatëse të ministrit që mbulon çështjet e strehimit, këshillon për:

a) linjat kryesore të ndërhyrjes në sektorin e strehimit, sipas objektivave të përcaktuar nga politika e strehimit dhe programet ekonomike kombëtare, duke u përqendruar në:

i) plotësimin e nevojave parësore për strehim;

ii) uljen e kostove të ndërtimit dhe menaxhimit të banesave;

iii) kërkesat për industrializimin e sektorit;

b) nivelin e fondeve buxhetore për strehimin, sipas këtij ligji;

c) kriteret e ndarjes së burimeve të financimit për programet sociale të strehimit, sipas këtij ligji;

ç) kriteret për ndarjen e fondeve, sipas njësive vendore.

Këshilli Kombëtar për Strehimin miraton, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e strehimit, programet kombëtare 10-vjeçare të strehimit dhe bën rishikimin eventual të tij;

d) për programet kombëtare 10-vjeçare të strehimit, të përgatitura nga ministria që mbulon fushën e strehimit.

3. Përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit, zhvillimi i veprimtarisë dhe marrëdhëniet e Komitetit Kombëtar të Strehimit me strukturat e tjera, që veprojnë në këtë fushë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35
Funksionet e bashkive

Bashkitë, për menaxhimin e programeve të strehimit, sipas këtij ligji, kryejnë funksionet e mëposhtme:

a) identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre;

b) hartojnë programe 10-vjeçare për strehimin dhe projekte trevjeçare, bazuar në burimet financiare që zotërojnë;

c) sigurojnë sheshet e ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji;

ç) paraqesin kërkesat pranë ministrit që mbulon fushën e strehimit, për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji;

d) krijojnë dhe administrojnë, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji;

dh) përcaktojnë kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e strehimit, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji;

e) sigurojnë ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira;

ë) njoftojnë çdo vit ministrin që mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji;

f) kryejnë të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

Neni 36

Ngritja e kapaciteteve dhe afatet

1. Ministri që mbulon fushën e strehimit, ministri që mbulon çështjet e decentralizimit dhe Ministri i Financave përcaktojnë përbërjen, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të strukturave përgjegjëse, për zbatimin e këtij ligji, pranë bashkive, sipas mundësive të burimeve financiare dhe njerëzore të bashkive.

2. Ministri që mbulon çështjet e decentralizimit dhe ministri që mbulon fushën e strehimit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë dhe miratojnë kurrikulën e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore, në zbatim të këtij ligji.

3. Ministrat e përmendur në pikën 2 të këtij neni, në bashkëpunim me institucionet vendase dhe të huaja dhe në kuadër të programeve të decentralizimit, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, realizojnë fazën e parë të trajnimit për të gjitha bashkitë.

4. Bashkitë, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, plotësojnë detyrimet sipas shkronjave "a" e "b" të nenit 35 të këtij ligji.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 37

Sanksionet

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

a) për shkelje të pikës 2 të nenit 10, kundërvajtësi gjobitet me një shumë nga 100 deri në 200 për qind të qirasë mujore;

b) për shkelje sipas shkronjës "a" të nenit 12, qiramarrësi detyrohet të kthejë shumën e përfituar nga granti, për periudhën që vërtetohet ndryshimi i të ardhurave;

c) për shkelje sipas shkronjës "b" të nenit 12, qiramarrësi gjobitet me një shumë nga 20 000 deri në 40 000 lekë;

ç) për shkelje sipas shkronjës "c" të nenit 12 dhe pikës 1 të nenit 20, qiramarrësi gjobitet me një shumë nga 40 000 deri në 60 000 lekë;

d) falsifikimi i bonusit të strehimit dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Vendosja e sanksioneve bëhet nga entet menaxhuese. Organi i ngarkuar për ekzekutimin e sanksioneve është policia bashkiake.

3. Kundër vendimeve të entit menaxhues për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankesë brenda 10 ditëve pranë kryetarit të bashkisë, i cili duhet të marrë vendim dhe të njoftojë të interesuarin brenda 30 ditëve.

4. Kundër vendimit të kryetarit të bashkisë mund të bëhet ankesë në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 38
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pikat 3 e 4; të nenit 8; të nenit 9 pika 1; të nenit 17 pikat 2 e 3; të nenit 18 pika 2; të nenit 22 pika 1 dhe të nenit 34 pika 3 të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri që mbulon fushën e strehimit, Ministri i Financave, ministri që mbulon çështjet sociale, ministri që mbulon çështjet e decentralizimit dhe bashkitë për zbatimin e këtij ligji.

Neni 39
Shfuqizime

Ligji nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4239, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Lidhja "A"

Për llogaritjen e kufirit minimal dhe maksimal të të ardhurave të familjes që përfiton banesa sociale me qera përdoren formulat e mëposhtme:

$$1. \text{Kufiri minimal i të ardhurave (Kmi)} = \left[\frac{Vb \times 0,04}{12 \times 0,25} \right] \times 0,5$$

a- ku Vb është vlera e banesës sipas shkronjës "a" të nenit 6 të këtij ligji;

$$b- \frac{(Vb \times 0,04)}{12}$$

është masa mujore e qirasë, vlera vjetore e së cilës llogaritet sa 4% e vlerës së banesës, e përcaktuar në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji;

c - treguesi 0,25 përcaktohet nga shkronja "b" e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji;

ç - treguesi 0,5 është masa e subvencionit të qirasë, sipas pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji.

$$2. \text{Kufiri maksimal i të ardhurave (Kmax)} = \frac{Vb \times 0,04}{12 \times 0,25}$$

Shembull: Vlera e banesës është 3 000 000 lekë. Masa e qirasë mujore të pasubvencionuar është $Vb \times 0,04/12 = 1\,000$ lekë. Kufiri minimal i të ardhurave të familjes është $10\,000/0,25 \times 0,5 = 20\,000$ lekë ($\pm 10\%$), ndërsa kufiri maksimal i të ardhurave është $10\,000/0,25 = 4\,000$ lekë ($\pm 10\%$).

Lidhja "B"

Formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së bonusit të strehimit është:

$$\zeta = Q - A \times 0,3 \text{ ku } \zeta \leq Q_m \times 0,5$$

a- ζ është vlera e bonusit;

b- Q është qiraja aktuale të cilën paguan familja;

c- A janë të ardhurat e familjes;

ç- Treguesi 0,3 përcaktohet nga fakti që pagesat e qirave mujore në rastin e bonusit të strehimit, nuk duhet të jenë më shumë se 30 për qind e të ardhurave mujore;

d- Q_m është vlera minimale e qirave të banesave në tregun e lirë, e llogaritur sipas pikës 8 të nenit 2 të këtij ligji;

dh- Treguesi 0,5 është ai i përcaktuar nga neni 15 i këtij ligji.

Vlera e bonusit të strehimit për një bashki të caktuar luhetet nga 0 deri në $Q_m/2$, në varësi të të ardhurave të familjes. Për një vlerë qiraje minimale të përcaktuar Q_m , vlerat maksimale dhe minimale të bonusit të strehimit, në varësi të të ardhurave të familjes llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\zeta_{\max} = Q_m/2 \text{ kur } A = [Q - Q_m \times 0,5] / 0,3 (\pm 10\%)$$

$$\zeta_{\min} = 0, \text{ kur } A \geq Q/0,3 (\pm 10\%)$$

Shembull 1: Nëse në bashkinë A, niveli minimal i qirasë është 12 000 lekë në muaj për një apartament me strukturë 2+1 dhe familja paguan një qira prej 20 000 lekësh në muaj, ndërsa të ardhurat e familjes janë 35 000 lekë në muaj, vlera e bonusit për këtë familje do të jetë:

$\zeta = 14000 - 35000 \times 0,3 = 3500$ lekë. Vlera maksimale e bonusit është: $\zeta \leq 6000$ lekë. Në këtë rast vlera e bonusit do të jetë 3 500 lekë, ndërsa familja duhet të paguajë vet diferencën prej 10500 lekësh, midis vlerës së qirasë prej 14 000 lekësh dhe vlerës së bonusit. Për të jetuar familjes i ngelen 24 500 lekë në muaj.

Nëse pas llogaritjeve rezulton se ajo që i ngelet familjes për të jetuar pasi ka paguar diferencën që i takon nga llogaritjet e mësipërme për qiranë, rezulton më e vogël se masa e ndihmës ekonomike të plotë, vlera e bonusit rillogaritet për të mos lejuar familjen të bjerë poshtë masës së ndihmës ekonomike të plotë. Kjo rillogaritje bëhet duke mbajtur parasysh kufirin maksimal të vlerës së bonusit.

Shembull 2: Nëse në të njëjtën bashki e njëjta familje jeton në një banesë me qira mujore prej 20 000 lekësh në muaj, vlera e bonusit të strehimit është $\zeta = 20\,000 - 35\,000 \times 0,3 = 9\,500$ lekë. Kjo vlerë është 3 500 lekë më shumë se vlera maksimale e përfuturit për këtë bashki, për rrjedhojë familja përfiton vetëm shumën prej 6 000 lekësh.

Lidhja "C"

Përcaktimi i kufirit maksimal dhe minimal i të ardhurave të familjes që përfiton nga banesat me kosto të ulët.

1. Kufiri minimal i të ardhurave të familjes:

$A_{\min} = PMT1/0,35$, ku:

a- A janë të ardhurat mujore të familjes,

b- $PMT1 = f(i, n, v)$ është pagesa mujore e kredisë së subvencionuar, e cila është funksion i interesit të kredisë (i), afatit të maturimit (n) dhe 60 - 80% të vlerës së banesës (v). Të dhënat e kësaj formule për treguesit (i), (n) dhe (v) merren nga banka me të cilën është nënshkruar kontrata e menaxhimit të kredisë;

c- Treguesi 0,35 është ai i përcaktuar në shkronjën "b" të nenit 19 të këtij ligji.

2. Kufiri maksimal i të ardhurave mujore të familjes:

$A_{\max} = PMT2/0,35$, ku $PMT2$ është pagesa mujore e kredisë së pasubvencionuar.

Shembull: Vlera e banesës është 25 000 USD, kredia jepet për 80 për qind të vlerës së banesës, me interes 7,8 për qind në vit dhe afat maturimi 15 vjet. Qeveria subvencionon 4,3 për qind të interesit (pa principialin). Sipas llogaritjeve pagesat mujore të kredisë së subvencionuar rezultojnë 143 USD ose 17150 lekë, ndërsa ato të kredisë së pasubvencionuar rezultojnë 189 USD ose 22659 lekë. Niveli minimal i të ardhurave të familjes duhet të jetë $A_{min} \geq 17150/0,35 = 49000$ lekë. Niveli maksimal i të ardhurave do të jetë $A_{max} \leq 22659/0,35 = 64740$ lekë.

LIGJ
Nr.9233, datë 13.5.2004

PËR NJË SHITESË TË LIGJIT NR.8153, DATË 31.10.1996 “PËR STATUSIN E JETIMIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Data 20 maj shpallet Dita Kombëtare në Ndhimë të Jetimëve”,

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4240, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 9234, datë 20.5.2004

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR
ZHVILLIM (IDB) PËR FINANCIMIN E FAZËS SË DYTË TË PROJEKTIT TË SPITALIT
TË PËRGJITHSHËM DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e fazës së dytë të projektit të Spitalit të Përgjithshëm Durrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4241, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
**KREDIE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E FAZËS-II TË PROJEKTIT TË
SPITALIT TË PËRGJITHSHËM NË DURRËS**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më 30/01/2004 H, e cila i përkon 12/03/2004G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim të quajtur “Kredimarrës”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim referuar si “Banka”), në të cilën:

A) Kredimarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë për mbulimin e kostos së financimit të fazës II të projektit të Spitalit të Përgjithshëm në Durrës (në vijim të quajtur “Projekti”) sipas përshkrimit në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje duke siguruar kredinë e dhënë më poshtë;

B) Një nga qëllimet e Bankës është që të ndihmojë vendet e veta anëtare duke livruar kredi për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore i përligjur;

D) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t’i japë Kredimarrësit kredinë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë;

Për këto arsye, palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizimet, kushtet e përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizimet: Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga kuptimi rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara që jepen si më poshtë vijon:

- a) “Disbursim” do të thotë tërheqje e shumës së kredisë.
- b) “Procedurë e disbursimit” do të thotë procedurë e disbursimit e Bankës.
- c) “Datë e vlefshme” do të thotë data në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Kredimarrësit.
- d) “Agjencia zbatuese” do të thotë Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë që është institucioni zbatues përgjegjës për realizimin, drejtimin dhe kontrollin e Projektit ose cilido institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe nga Banka.
- e) “Kushte të përgjithshme” do të thotë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për kredi dhe marrëveshje garantuese të Bankës që i përkasin datës 8.11.1976.
- f) “Dinari islamik/DI” siç përkufizohet në nenin 4(1)(a) të Marrëveshjes themeluese të Bankës është njësia për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar.
- g) “Shumë e kredisë” do të thotë shuma për të cilën Banka ka rënë dakord t’ia japë Kredimarrësit në mënyrën e përcaktuar në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.
- h) “Agjencia paguese” do të thotë Ministria e Financave e Kredimarrësit.
- i) “Shuma themelore” do të thotë shuma në total e kredisë, aktualisht e tërhequr nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje.
- j) “Udhëzime të prokurimit” do të thotë udhëzimet për prokurim të mallrave dhe shërbimeve të financuara nga Banka.
- k) “Projekti” dhe referime në “pjesë” të tij do të thotë Projekti dhe pjesë të tij, ashtu siç janë përshkruar në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje.
- l) “Tarifë e shërbimit” do të thotë tarifa që i paguhet Bankës nga Kredimarrësi ashtu siç përcaktohet në seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha parashikimet e kushteve të përgjithshme si njëlloj të vlefshme dhe efektive, ashtu siç paraqiten në vijim.

Neni 2

Kredia

Seksion 2.01 Shuma e kredisë: Banka bie dakord t’i japë Kredimarrësit kredi nga burimet e veta të zakonshme, në një shumë që nuk tejkalon barasvlerën e DI 5,420,000 (Dinarë islamikë pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) vetëm sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga Marrëveshja e kredisë, do të prokurohen me anë të procedurave të tenderit Ndërkombëtar (PTN), të kufizuar për vendet anëtare në përputhje me udhëzuesit e prokurimit të Bankës. Për këtë arsye, Kredimarrësi do t’u përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj Izraelit.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 3.01 Tërheqja: shuma e kredisë do të tërhiqet nga Kredimarrësi sipas tabelës III dhe parashikimeve të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurës së disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e pranueshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin, për të cilin është rënë dakord sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë:

Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshmerisë ose çdo datë tjetër të mëvonshme siç do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, Kredimarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë të pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Kredimarrësit.

Seksioni 3.03 Data e përfundimit të disbursimit: 31/12/2007 ose një datë e mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga shuma e kredisë për qëllime të seksionit 6.03 (c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.04 Përdorimi i shumës së kredisë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Kredimarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të Projektit të financuar nga Banka.

Neni 4

Zhvleftësimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 4.01 Zhvleftësimi: Kredimarrësi do të ripagujë shumën themelore në 25(njëzetë e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë faljeje 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore siç parashikohet në tabelën II (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Tarifa e shërbimit:

a) Kredimarrësi do t'i pagujë Bankës një tarifë shërbimi në një shumë të vlerësuar fillimisht në 422,760 DI (katërqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë dinarë islamikë), sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën II (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga palët në këtë marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, tek e cila referon nënseksioni 4.02 (a), është veçse një vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë siç është konceptuar këtu. Gjithashtu, bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përlllogaritet pas zbatimit të Projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të akumulohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Vendet e pagesave: Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave janë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 4.04 Pa ndonjë paragjykim për tërësinë e parashikimeve të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të gjykohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

a) Nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë:

Llogaria nr. GB14 GULF 4053 0700 1591

Gulf International Bank B.S.C.

London Branch

One Knightsbridge

London SW1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

SWIFT CODE: GULFGB2L

b) Nëse kjo pagesë është bërë në paund britanikë:

Llogaria nr. 122432 GBP2520 01

Gulf International Bank B.S.C.

London Branch

One Knightsbridge

London SW1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

Tlx. Nr. 8812889/8813326 GIBANK G

SWIFT CODE: GULFGB2L

c) Nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro:
Llogaria nr. 096965 001 51
(Union De Banques Arabes Et Francaises (UBAF)/Bashkimi I Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
Francë
Teleks Nr. 610334 UBAF
SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 5 **Zbatimi i projektit**

Seksioni 5.01 Kredimarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë Projektin dhe të drejtojë punimet e tij përmes agjencise së zbatimit me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikatat e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me eksperiencë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetit, planifikimet dhe specifikimet lidhur me Projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi nga ana e saj të çdo ndryshimi të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specifikimet e Projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash lidhur me zbatimin e Projektit.

Neni 6 **Parakushte shtesë përpara disbursimit nga Banka**

Kredimarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, duhet të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përpara se të shpallë.

Neni 7 **Klauzola të veçanta**

Seksioni 7.01 Kredimarrësi do të ketë gjendje, sapo t'i kërkohet, të gjitha shumatat që përfshijnë sasinë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e Projektit sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveç se kur Banka bie dakord ndryshe, Kredimarrësi do të trajtojë të gjitha kontratat që financohen nga vazhdimësia e kësaj kredie për zbatimin e Projektit përmes procedurave ndërkombëtare të tenderit të kufizuar për vendet anëtare të BIZH (IDB) dhe do të kërkojë miratim paraprak nga Banka për shpalljen fituese të çdo kontrate, vlera e të cilës tejkalon shumën ekuivalente prej njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë (DI 150,000).

Seksioni 7.03 Kredimarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të Projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre në një mënyrë të detajuar sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e kredisë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në Projekt, të dokumentojë ecurinë e Projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikatat e konsoliduara të kontabilitetit veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Kredimarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akredituar të Bankës me qëllime të lidhur me Projektin, si dhe për të kontrolluar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistrë tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së Projektit, mallrave dhe veprimeve si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Kredimarrësi angazhohet, me qëllim për të çuar më tej dhe për të zbatuar Projektin, të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës në përputhje me rregullat dhe udhëzimet si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi, administratë dhe drejtues të përshtatshëm për ecurinë e nevojshme dhe efikase të veprimtarisë së Projektit.

Seksioni 7.07 Kredimarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i kredisë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transit dhe rreze të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Kredimarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të Projektit dhe do të sigurohen në shuma që janë në përputhje me praktikën tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e kredimarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumat e sigurimit në monedhë lehtësisht të shkëmbyeshme.

Seksioni 7.08 Kredimarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohet si e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të siç kërkohet për realizimin e Projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të Projektit.

Seksioni 7.09 Kredimarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet kur të jetë e nevojshme për të lejuar institucionin zbatues të realizojë Projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që mund të ndalojë, ose ndërhyjë në zbatimin, ose veprimarinë e Projektit, ose në përmbushjen e çdonjërit prej parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Kredimarrësi si çështje konfidenciale.

Neni 8 **Raportet**

Seksioni 8.01

a) Kredimarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se objektivat e Kredisë do të përmbushen. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar lidhur me gjendjen e përgjithshme të Kredisë. Nga ana e Kredimarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Kredimarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Kredimarrësit.

b) Kredimarrësi dhe Banka në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës palë do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve përkatës për sa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e Kredisë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Kredimarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin ose të ndikojë për dorëzimin në Bankë të secilit nga raportet e mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë afati tjetër që palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e Projektit në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here në mënyrë të detajuar;

ii) raporte të tjera që Banka në mënyrë të arsyetuar do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së kredisë të disbursuar dhe ecurinë e Projektit;

iii) Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një date të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Kredimarrësi dhe Banka, Kredimarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë

me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të Projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të noterizohen sipas vullnetit të lirë të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9 Vlefshmëria

Kjo Marrëveshje nuk do të ketë efekte deri sa:

A) (1) Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Kredimarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga të gjitha instancat përkatëse të qeverisjes;

(2) Kredimarrësi do të dorëzojë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën që buron nga autoriteti ligjor i kredimarrësit, duke deklaruar se Marrëveshja e Kredisë është autorizuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur në emër të Kredimarrësit. Deklarata do të shprehë se Marrëveshja përbën një detyrim ligjor për Kredimarrësin sipas kushteve të veta.

B) Një letër autorizimi do të nënshkruhet nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion tjetër i autorizuar për këtë qëllim nga ana e Kredimarrësit për bankën qendrore ose subjektin që ushtron funksionet e një banke qendrore, se pagesa nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje e shumës themelore dhe kështet e tarifës së shërbimit do të kryhen nga banka qendrore, ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara. Një kopje e letrës së autorizimit së bashku me një vërtetim nga banka qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, e cila demonstroi se është marrë letra e autorizimit dhe se do t'i bashkëngjitet udhëzimeve të përfshira në të do t'i dërgohet Bankës nga Kredimarrësi.

Neni 10 Përfundimi i marrëveshjes për moszbatueshmëri

Nëse Marrëveshja nuk zbatohet brenda 12 muajve nga data e nënshkrimit e cituar në të, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveç se kur Banka pas marrjes në konsideratë të të gjitha shkaqeve të vonësës do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka menjëherë do të njoftojë Kredimarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11 Parashikime të ndryshme

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar: Ministri i Financave i Kredimarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Kredimarrësit për qëllime të Seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa: Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Financave

Bul. "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë-Shqipëri.

Tel./Fax.: ++355 4 228-494

Për Bankën Islamike për Zhvillim:

P.O. Box: 5925

Jeddah 21432

Mbretëria e Arabisë Saudite

Teleks: 601137 ISDB SJ

Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH

Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, secili duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më lart.

TABELA I
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i Projektit është të ndihmojë popullsinë e Durrësit dhe zonave përreth me një shërbim shëndetësor të përparuar. Kjo mund të realizohet edhe duke shtuar një infrastrukturë prej 160 shtretër, meqenëse realizimi i kësaj është parashikuar në master planin fillestar për këtë spital rajonal me kapacitet prej 400 shtretër. Kështu pra, do të realizohen nevojat e qytetit dhe zonave përreth.

Zbatimi i Projektit përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- i) Punimet civile;
- ii) konsulencën;
- iii) njësinë e menaxhimit të Projektit;
- iv) shërbimin e auditimit dhe
- v) pajisjet dhe orenditë mjekësore.

TABELA II (A)
RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE

Shteti: Republika e Shqipërisë

Projekti: Faza-II e Spitalit të Përgjithshëm në Durrës

Shuma e Kredisë: DI. 5,420,000/-

Periudha e Kredisë: 25 vjet.

Periudha e faljes: 7 vjet.

Tarifa e shërbimit: 422,760 DI.

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06. 2011	150,555
2	31.12. 2011	150,555
3	30.06. 2012	150,555
4	31.12. 2012	150,555
5	30.06. 2013	150,555
6	31.12. 2013	150,555
7	30.06. 2014	150,555
8	31.12. 2014	150,555
9	30.06. 2015	150,555
10	31.12. 2015	150,555
11	30.06. 2016	150,555
12	31.12. 2016	150,555
13	30.06. 2017	150,555
14	31.12. 2017	150,555
15	30.06. 2018	150,555
16	31.12. 2018	150,555
17	30.06. 2019	150,555
18	31.12. 2019	150,555
19	30.06. 2020	150,555
20	31.12. 2020	150,555
21	30.06. 2021	150,555
22	31.12. 2021	150,555
23	30.06. 2022	150,555

24	31.12. 2022	150,555
25	30.06. 2023	150,555
26	31.12. 2023	150,555
27	30.06. 2024	150,555
28	31.12. 2024	150,555
29	30.06. 2025	150,555
30	31.12. 2025	150,555
31	30.06. 2026	150,555
32	31.12. 2026	150,555
33	30.06. 2027	150,555
34	31.12. 2027	150,555
35	30.06. 2028	150,555
36	31.12. 2028	150,560
Totali:		5,420,000

TABELA II (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti: Republika e Shqipërisë

Projekti: Faza-II e Spitalit të Përgjithshëm në Durrës

Shuma e Kredisë: DI. 5,420,000/-

Periudha e Kredisë: 25 vjet.

Periudha e faljes: 7 vjet.

Tarifa e shërbimit: 422,760 DI.

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06.2004	16,900
2	31.12.2004	33,821
3	30.06.2005	33,821
4	31.12.2005	33,821
5	30.06.2006	33,821
6	31.12.2006	33,821
7	30.06.2007	23,675
8	31.12.2007	23,675
9	30.06.2008	23,675
10	31.12.2008	23,675
11	30.06.2009	23,675
12	31.12.2009	23,675
13	30.06.2010	23,675
14	31.12.2010	23,675
15	30.06.2011	23,675
16	31.12.2011	23,675
Totali:		422,760

TËRHEQJE NGA TË ARDHURAT E KREDISË

1. Shuma e Kredisë prej DI.5,420,000/- (pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) do të përdoret për të mbuluar kostot e zërave të mëposhtëm:

US\$ milion

Përshkrimi i komponentëve	Qeveria Shqiptare		F/C	L/C	IDB		Totali i secilit Komponent	
	Amount	%			Amount	%	Amount	%
Punime civile (Ndërtim)	-	0	2.683	3.059	5.742	100	5.742	100
Shërbime konsulence (Proj, Super.)	-	0	0.460	-	0.460	100	0.460	100
Njësia e menaxhimit të projektit (PMU)	0.090	49	0.012	0.081	0.093	51	0.183	100
Pajisje dhe orendi mjekësore	0.980	100	-	-	-	0	0.980	100
Shërbime auditimi	-	0	-	0.090	0.090	100	0.090	100
Workshope dhe vizitë familjarizimi në IDB HQ	-	0	0.010	0.010	0.020	100	0.020	100
Sub-total	1.070	14	3.165	3.240	6.405	86	7.475	100
Rezervë si të paparashikuara	0.107	14	0.317	0.324	0.641	86	0.748	100
Total	1.177	14	3.482	3.564	7.046	86	8.223	100

2. Shumat e shpërndara në këtë tabelë janë vlerësime paraprake. Shumat përfundimtare do të përcaktohen gjatë zbatimit të Projektit në përputhje me kostot aktuale brenda shumës së kredisë.

ID429 - Shqipëria - mhk

DEKRET

Nr.4243, datë 8.6.2004

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË KOMUNËN HUDENISHT, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të nenit 14 pika 5 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Hudenisht, qarku Korçë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 4 korrik 2004.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4244, datë 8.6.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 9 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ardian Fadil Popoviq
2. Skënder Ibrahim Blakçori
3. Attila Béla Borbáth
4. Raphael Faust

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.349, datë 1.6.2004

PËR FILLIMIN E NEGOCIMIT PËR DHËNIEN ME KONCESION TË ZONËS SË PORTO-ROMANOS, DURRËS DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE, QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE, PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e negociimit për dhënien me koncesion, si propozim i pakërkuar, sipas projektit të shoqërisë Romano Port sh.a., për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, i miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Procedura për administrimin e infrastrukturës portuale detare të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Dhënia me koncesion, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit në funksion të depozitave bregdetare të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të jetë e formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim).

4. Organi Shtetëror i Autorizuar për negocimin (OSHA) të jenë Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, të cilët të ngrenë grupin e negocimit për marrëveshjen koncesionare përkatëse.

5. Përpara realizimit të marrëveshjes koncesionare të bëhet rakordimi i projektit të propozuar, ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve e Institutit të Kërkimeve të Transportit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike apo infrastrukturë”.

6. Negocimi dhe hartimi i marrëveshjes përfundimtare ndërmjet OSHA-së dhe koncesionarit të realizohen brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi. Në marrëveshjen koncesionare të përfshihet edhe rregullimi i marrëdhënieve ekonomiko-financiare, ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe OSHA-së, për administrimin e infrastrukturës portuale detare të ngarkim-shkarkimit dhe transportimit të naftës, gazit e të nënprodukteve të tyre, deri në depozitat magazinuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Pas këtij afati, në rast mosplotësimi të kushteve të pikës 6, vendimi humbet fuqinë vepruese.

8. Pika 13 e 14 të vendimit nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive, që do të ndërtojnë dhe do të përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.350, datë 1.6.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË
REPARTIT USHTARAK NR.1023 NË QYTETIN E VLORËS, TË CILAT JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të repartit ushtarak nr.1023, në qarkun e Vlorës, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për ndërtimin e objekteve të sistemit të paraburgimit, në prefekturën e Vlorës.

2. Prona me numër rendor 881 “Mjediset e repartit ushtarak nr.1023”, në Vlorë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet t'ia ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.351, datë 1.6.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 10.5.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhet kjo shtesë:

- Në listën e objekteve për kalimin e së drejtës së pronësisë organeve të qeverisjes vendore të shtohen objektet sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Objektet, që u kalojnë në pronësi organeve të qeverisjes vendore, të përdoren sipas destinacionit, të përcaktuar në listën e përmendur në pikën 1.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetarët e bashkive të Durrësit, Fierit, Vlorës dhe Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LISTA E OBJEKTEVE PËR KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Nr.	Objekti	Subjekti që e administron	Vendodhja e Objektit	Vartësia administrative	Kolon në Pronësi	Destinacioni i Përdorimit
1	Ndërtesa e magazinës dhe administratës, Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
2	Kapanoni i parkimit të makinave-Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
3	Ndërtesat e repartit mekanik Durrës	Albbakër sh.a. Tiranë,	Durrës	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Durrës	Për fond banese
4	Ngrehinë mence, Vlorë	Servcom sh.a. Fier	Vlorë	Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	Bashkisë Vlorë	Për fond banese
5	Hotel i ri, Kukës	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Kukës	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Bashkisë Kukës	Zyra për administratën
6	Fabrika e re e miellit, Fier	Drejtoria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Fier	Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Bashkisë Fier	Ndërtime banesash Për të pastrehët

VENDIM
Nr.352, datë 1.6.2004

**PËR HEQJEN NGA LISTA E SEKTORËVE STRATEGJIKË DHE KALIMIN NË
PRIVATIZIM A MBYLLJE TË FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT, NË KALIMASH,
NË QARKUN E KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga lista e sektorëve strategjikë me rëndësi të veçantë dhe kalimin në procesin e privatizimit, të mbylljes a likuidimit të fabrikës së pasurimit të kromit, në Kalimash, në qarkun e Kukësit.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës të përgatisë, brenda vitit 2004, dokumentacionin e nevojshëm për privatizimin e kësaj fabrike.

3. Fondet, që nevojiten për ruajtjen e objekteve të kësaj fabrike, deri në privatizimin e mbylljes së saj, dhe për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit a mbylljes, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Albikrom, sh.a.-në.

4. Punonjësit, që dalin të tepërt si pasojë e kalimit në privatizim a mbyllje të fabrikës, të cilët para datës 1.5.2004 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e privatizimit apo mbylljes, të trajtohen për 1 (një) vit me pagë bazë, që ata kanë në çastin e shkëputjes nga puna.

5. Periudha njëvjeçare për këta punonjës të njihet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti a familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm dhe të shënohet në librezën e punës.

6. Fondi i nevojshëm për trajtimin e punonjësve të shkurtuar dhe për pagesën e kontributit të sigurimit të ndryshueshëm shoqëror për periudhën e trajtimit të përballohet nga fondet e vitit 2004, miratuar për Albikrom, sh.a.-në dhe fondet e siguruara nga kjo shoqëri nga shitjet e aseteve të saj.

7. Caktimi, administrimi dhe trajtimi me pagën bazë për një vit i punonjësve që dalin të papunë nga procesi i privatizimit të bëhen nga zyra përkatëse e punësimit pas transferimit të fondit.

8. Të drejtën e përfitimit të trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës, të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, si punëdhënës, punëmarrës apo të vetëpunësuar, me përjashtim të rasteve të të vetëpunësuarve në bujqësi. Në rast të kundërt u ndërpritet pagesa që përfitojnë sipas këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.353, datë 1.6.2004

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE NË
MISIONET JASHTË SHTETIT, EDHE NË RASTE AKSIDENTESH NË GRUP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 pika 3 dhe 19 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes, që, me fondin e vet limit prej 33 435 000 (tridhjetë e tre milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me INSIG, sh.a.-në, për sigurimin e jetës së ushtarakëve me misione jashtë shtetit, edhe në raste aksidentesh në grup.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 16.6.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë